

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **631-26-6015-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material hixhenik për institucione publike të Komunës së Deçanit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.T.SH. GIPA
NUI	600583323
Adresa	Rr. Luan Haradinaj p.n.
Vendi	Deçan
Kodi postar	51000
Numri Telefonit	+38349630900
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Milot Iberhysaj
Adresa elektronike	gipantsh@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	07.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material hixhenik për institucione publike të Komunës së Deçanit

•B05 Njoftim per Kontrat 24.07.2026

•B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
Dt:30.07.2026

•Afati i fundit për dorëzimin e ofertave sipas njoftimit për kontratë ka qenë
11.08.2026 ne ore 14:00

•Hapja e Ofertave të tenderit është bërë me dt. 11.08.2026 ne ore 14:00

•Kerkes per rishqyrtim me daten i DT:04.08.2026

•Vendim për Pezullim i DT:05.08.2026

•Përgjigje në Kërkesën për Rishqyrtim DT:06.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Refuzim i kërkeses për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 par.1 dhe 3 të ligjit nr.04/L-042 – Qëllimi.

Neni 7 par. 1 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Barazia në Trajtim Jo Diskriminimi.

Neni 41 i dftdhe UOPP-së - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Neni 51 të LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i kriterëve të Përzgjedhjes.

Neni 52 Par 4 i LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i Kriterëve për Dhënie të kontratës.

Neni 56 të LPP-së nr.04/L-042 - Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe Dhënie të kontratave.

Neni 69 i LPP-së nr.04/L-042 - Aftësitë teknike dhe/ose profesionale.

Neni 72 i LPP-së nr.04/L-042 – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kriteri për automjetet është diskriminues dhe kufizon konkurrencën

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar që operatorët ekonomikë të posedojnë:

- 2 automjete bartëse me 5 dyer;
- 1 automjet pick-up;
- 1 furgon me lift me 3 dyer për bartjen e mallit;

- 1 kamion 7T me lift.

Vlerësojmë se ky kriter është i panevojshëm, joproporcional dhe kufizon konkurrencën.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim pse për realizimin e kësaj kontrate duhet domosdoshmërisht të posedohen pikërisht këto automjete dhe pikërisht në këtë konfigurim. Në dosjen e tenderit nuk është shpjeguar pse nuk do të mjaftonin automjete të tjera që kanë të njëjtin funksion dhe të njëjtin kapacitet transportues.

Veçanërisht, kërkesa që furgoni me lift të jetë **me 3 dyer** është e pajustificuar. Numri i dyerve nuk ndikon në transportimin e mallrave. Një furgon me 4 ose 5 dyer, i pajisur me lift, e kryen të njëjtën punë dhe ka të njëjtin funksion.

Ne baze UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK te Nenit: 8.5 Kriteret e përzgjedhjes

Tabela e mëposhtme paraqet Kriteret e përzgjedhjes që mund të përdorën nga Autoriteti Kontraktues:

3. Aftësitë teknike dhe/ose profesionale	Në rast të kontratës për furnizim të produkteve:	
	a) Vlera minimale në lidhje me furnizimet në 3 vitet e fundit	a. Një listë që liston furnizimet kryesore relevante të OE që specifikon: produktet e përfshira, shumën kontraktuale, datën dhe pranuesin / certifikata e pranimi
	b) Kërkesat minimale të mundësive teknike të OE	b. Përshkrim i mundësive teknike të OE

Për këtë arsye, gjatë periudhës së sqarimeve kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të lejohen edhe furgonët me lift me 4 ose më shumë dyer. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues e refuzoi kërkesën dhe nuk dha asnjë arsyetim teknik apo profesional pse kërkohet vetëm furgon me 3 dyer.

Po ashtu, edhe kërkesa për posedimin e një kamioni 7T me lift është e paarsyetuar. Autoriteti Kontraktues nuk ka treguar pse një kamion i tillë është i domosdoshëm për realizimin e kontratës dhe pse automjete të tjera me kapacitet të mjaftueshëm nuk mund ta realizojnë të njëjtin furnizim.

Vendosja e këtyre kërkesave e kufizon pjesëmarrjen vetëm te operatorët ekonomikë që posedojnë pikërisht këto automjete dhe përjashton operatorë të tjerë që kanë kapacitet të

plotë për ta realizuar kontratën. Kjo krijon avantazh të padrejtë për një numër të kufizuar operatorësh ekonomikë dhe bie ndesh me parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se ky kriter është vendosur në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe ta detyrojë Autoritetin Kontraktues ta ndryshojë Dosjen e Tenderit dhe kriteret për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 kekesa 5 në FDT të vendosen vlerat minimale të lejuar edhe maksimale të lejuara. Duke kërkuar vetëm automjete që janë të nevojshme dhe funksionalisht të përshtatshme për realizimin e kontratës, pa vendosur kufizime të panevojshme për llojin ose konfigurimin e tyre.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jonë si OE jemi të dëmtuarit në këtë tender-projekt, pasi konsiderojmë se nga AK janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së (të precizuara si më lartë)

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.